

**VENDIM**  
**Nr. 149, datë 29.2.2012**

**PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE PËR PUNONJËSIT E DREJTORISË SË SHËRBIMEVE QEVERTARE<sup>1</sup>**

*(Ndryshuar me VKM nr.325, datë 28.5.2014; nr.60, datë 27.1.2016; nr.236, datë 2.5.2018)*

*(I përditësuar)*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të ligjit nr. 10 405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare jepen sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, ku jepen elementet përbërëse, si më poshtë vijon:

*a) Kategoria ose klasa për çdo funksion, kolona 2, e lidhjes nr. 1. Vlera mujore e pagës për çdo kategori dhe klasë është e njëjtë me vlerën e pagës për kategorinë dhe klasën, të përcaktuara me vendimin përkatës për nëpunësit civilë dhe për punonjësit mbështetës të administratës publike.*

*b) Paga e grupit, kolona 3, e lidhjes nr. 1, e cila përfitohet vetëm për nëpunësit me arsim të lartë universitar në funksionet e përcaktuara në këtë lidhje. Vlera mujore e pagës së grupit është e njëjtë me vlerën e pagës së grupit, e përcaktuar me vendimin përkatës për nëpunësit civilë.*

c) Shtesa për vjetërsi në punë, kolona 4 e lidhjes nr. 1, jepet:

- në masën 2 për qind në muaj pas çdo viti pune deri në 25 vjet dhe llogaritet mbi pagën e grupit për kategorinë e nëpunësve me arsim të lartë universitar;

- në masën 1 për qind në muaj pas çdo viti pune deri në 25 vjet dhe llogaritet mbi pagën bazë për klasë për kategorinë e punonjësve me arsim të mesëm.

ç) Shtesa për natyrë të veçantë pune, kolona 5 e lidhjes nr. 1. Vlera mujore e saj jepet vetëm për funksionet e specifikuar në lidhjen nr. 1, bashkëlidhur vendimit.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi për vitin 2012, përballohen nga fondet e planifikuara për viti n 2012 për

---

<sup>1</sup> VKM nr. 149, datë 29.2.2012 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.30, datë 5 prill 2012.  
VKM nr.325, datë 28.5.2014 është botuar ne Fletoren Zyrtare nr.85, datë 11 qershor 2014.  
VKM nr. nr.60, datë 27.1.2016 është botuar ne Fletoren Zyrtare nr.11, datë 3 shkurt 2016.  
VKM nr.236, datë 2.5.2018 është botuar ne Fletoren Zyrtare nr.65, datë 5 maj 2018.

Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare.

3. Të gjitha dispozitat, që bien në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.  
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Sali Berisha**

Lidhja nr. 1

STRUKTURA E PAGËS SË PUNONJËSVE TË DREJTORISË SË  
SHËRBIMIT QEVERITAR

*(Shtuar funksioni “Zëvendësdrejtues” me VKM nr.325, datë 28.5.2014;  
ndryshuar lidhja nr.1 me VKM nr.60, datë 27.1.2016; ndryshuar me VKM  
nr.236, datë 2.5.2018)*

Funksioni	Kategoria Klasa	Paga e grupit (lekë)	Shtesa për vjetërsi (%)	Shtesa për kushte pune (lekë) bëhet
1	2	3	4	6
Titullar institucioni	I-b	1	2%	
Drejtore drejtorie	III-a	1	2%	
Shef sektori	III-a/1	1	2%	
Specialist auditi, specialist në Kryeministri; specialist/redaktor ligjor në Kryeministri	III-b	1 ose 2 ose 3	2%	
Sekretar (i titullarit dhe i Bordit Drejtues)	IV-b	1 ose 2 ose 3	2%	7000
Specialist kontabilist; specialist i burimeve njerëzore; specialist jurist; specialist prokurimesh; përgjegjës mirëmbajtje godina, përgjegjës sektori i pastrimit, përgjegjës i	IV-a	1 ose 2 ose 3	2%	

sektorit të ambienteve të jashtme; specialist koncept – desing, specialist logjistike, specialist shërbimi; përgjegjës i Qendrës së Transportit.				
Specialist; specialist finance, specialist buxheti; specialist kosto; specialist protokoll/arkivi; specialist IT, specialist mersolog, specialist trajtimi; specialist gjelbërimi, specialist inxhinier, sekretar për ish-presidentët.	IV-b	1 ose 2 ose3	2%	
Kryekuzhinier	X		1%	43500
Administrues vilash / qendrash	X		1%	12700
Kryepastiçier;	X		1%	17800
Magaznier i magazinës qendrore; Kryepunëtor Rezidenca Qeveritare; Banakier;	IX		1%	
Kryekamerier	IX		1%	17800
Ndihmëspastiçier	IX		1%	12700
Shofer/korrier; magaznier (magazinë dytësore); teknik të ndryshëm; punëtor në rezidenca qeveritare; kamerier	VIII		1%	
Teknik elektrikist/hidraulik/mirëmbajtje/kameraman/fotograf/operator shumëfishimi në Kryeministri	VIII		1%	7300
Kuzhinier Rezidenca e Kuvendit, Kryeministrit; Presidentit	VIII		1%	17800
Kuzhinier Vila 31;	VIII		1%	12700
Ndihmësmagaznier; ndihmëskuzhinier, shofer; teknik dispeçer	VII		1%	
Shofer titullari në Kryeministri	VII		1%	17800
Punëtorë mirëmbajtjeje; punëtor pastrimi, punëtor lavanderie; punëtor gjelbërimi; roje; lavazhier	V		1%	
Punëtor pastrimi në Kryeministri, receptionist	V		1%	7300

Lidhja nr.2

VLERA E PAGËS SË GRUPIT PËR DIPLOMAT E ARSIMIT UNIVERSITAR

*(Shfuqizuar me VKM nr.60, datë 27.1.2016)*

Lidhja nr.3

VLERA E PAGËS PËR ÇDO KATEGORI/KLASË

*(Shfuqizuar me VKM nr.60, datë 27.1.2016)*